



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM
Nr. 17, Dt. 25.09.2007

Per miratim te lejes se rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Kalase, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Blerimas (ne veri-perendim te tij), subjektit "Shameti" sh.p.k. komuna Vergo , Qarku Vlore.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Shameti" sh.p.k, konform formularit "F", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te miratoj lejen e rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Kalase, ne afersi te fshatit Blerimas (ne veri-perendim te tij), Komuna Vergo, subjektit "Shameti" sh.p.k. Delvine.
- 2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim do te jete 0.024 km².

E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte:

X 1 = 44 22 470
X 2 = 44 22 450
X 3 = 44 22 435
X 4 = 44 21 300

Y 1 = 44 17 590
Y 2 = 44 17 745
Y 3 = 44 17 810
Y 4 = 44 17 950

- Vazhdim i Projekt - Vendimit Nr. 17, Dt. 25.09.2007.
- 3- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06.2007 deri me 31.10.2007, duke u ricikluar cdo vit, deri me dt. 25.09.2010, duke vazhduar: nga 01.06.2008 deri 31.10.2008
nga 01.06.2009 deri 31.10.2009
nga 01.06.2010 deri 25.09.2010
 - 4- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 30 000 m³, me nje mesatare vjetore 10 000 m³/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m, por jo me shume se 0.5m mbi pasqyren e ujrave fratike.
 - 5- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.
 - 6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B-se “VJOSE”
Veizir METAJ



KRYETARE E K.B.U-se
Dorothe KONOMI

